



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.556/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Liridon Tmava, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Lipjan, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së, me Nr.2122-2021 i datës 28.08.2021, për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli Anr.556/2021 i datës 29.08.2021, i parashtruar nga Liridon Tmava kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së së Nr. 2122-2021 të datës 28.08.2021 për shkak të mos certifikimit si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan nga subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datë 30.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Liridon Tmava, në të cilin pretendon se nuk pajtohet me vendimin e KQZ-së, për mos certifikimin e tij, për shkak se sipas tij lëndën e ka të përfunduar dhe nuk ka asnjë ndalesë nga gjykata. Parashtruesi i apelit si provë ka bashkangjitur kopjen e Urdhërpagesës së Gjykatës dhe Fletëtransferin e gjobës së paguar në postë.

PZAP-i, me datën 30.08.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kërkesën për përgjigje në ankesë.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ, ka bërë përgjigjen në ankesë më datën 31.08.2021, në të cilën theksohet se në kuadër të obligimeve ligjore sipas nenit 29 të Ligjit të Zgjedhjeve të Përgjithshme-LZP-së, Zyra ka bërë verifikimin e dokumentacionit të gjithë kandidatëve nëse të njëjtit kanë ndalesa që do të ia bënin të pamundur kandidimin e tyre për Zgjedhjet Lokale 2021.

Më tutje në përgjigje thuhet se në kuadër të verifikimeve, Zyra me datë 22 Gusht 2021, i ka dërguar shkresë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që ti siguroj KQZ-së, emrat e individëve nga lista e tyre që me

vendim të gjykatës iu është hequr e drejta për të qenë kandidat apo janë shpallur fajtor për veprat penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në 3 vitet e fundit.

Më datë 24 Gusht 2021, Zyra për Certifikim, nga KGJK, ka pranuar shkresën me të cilën kandidati Liridon Tmava, kandidat nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me nr. rendore 2, për kuvendin Komunal ne Komunën e Lipjanit, është identifikuar se është i dënuar me Aktgjykim të plotfuqishëm Pnr. 550/2021 të datës 06.01.2021.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me refuzimin për certifikimin e tij nga gara për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Lipjan në zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021, i është bërë e pa drejtë, pasi që lënda e tij është e përfunduar, Paneli i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se cilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase parashtruesi i apelit me Aktgjykimin e plotfuqishëm P.550/2021 të datës 06.01.2021, është verifikuar si person i dënuar.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.2122-2021, të datës 28.08.2021, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 1 pika q) të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas Aktgjykimit të plotfuqishme P.550/2021 të datës 06.01.2021, dhe se me vendimin Nr.2122-2021 të datës 28.08.2021 lëshuar nga KQZ nuk është certifikuar lista me kandidatë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e rekomanduar nga ZRPPC me të cilën i njëjti nuk është i përfshirë në listën e rekomanduar dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Fakti se parashtruesi i apelit pretendon se lënda e tij ka përfunduar dhe nuk ka asnjë ndalës nga gjykata, për Panelin rrethanat e tilla nuk krijojnë mundësi për përshtatshmërinë e kandidatit bazuar ne kufizimet e përcaktuara ne nenin 29 par 1 pika q) te LZP-së, nga se kjo dispozite ka përcaktuar tri kritere, qe te jetë shpallur fajtor për vepër penale, qe te jetë dënuar ne tri vitet e fundit dhe qe vendimi te jetë i formës se prerë, për pasojë në rastin konkret që të tri këto kritere ligjore plotësohen dhe ka efekt për të drejtat që janë humbur si pasojë e dënimit penal, ndërsa sipas LPZ-së, për tu certifikuar kandidati për deputet duhet shikuar vetëm se a plotësohen këto tri kritere ligjore nga neni 29.1. pika q) te LZP-së, , kritere këto ligjore te mbivendosura ne zbatim për zgjedhjet qe organizohen ne Kosove, sipas dy vendimeve dhe atë, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KO95/2020 i datës 06.01.2021, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, nr. AA.nr. 4/2021 i datës 28.01.2021.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 dhe 5 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 556/2021 më datën 01.09.2021.

Kryesues i Panelit

Zyher Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.